

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E drejta komparative në fushën e së drejtës private
Niveli:	MASTER
Statusi lëndës:	Detyruese
Viti i studimeve:	I (semestri I)
Numri i orëve në javë:	3+0
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	Prishtinë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. iur. Iset Morina LL. M. (Würzburg)
Detajet kontaktuese:	Konsultimet: Pas ligjërates. Online: sipas marrëveshjes Adresa elektronike: iset.morina@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	E drejta komparative në fushën e së drejtës private merret kryesisht me krahasimin e të drejtave të vendeve të ndryshme. Krahasimi i të drejtave të tjera mund të jetë i fokusuar në krejt fushën e së drejtës në përgjithësi, por meqë kursi i studimeve Master është i drejtuar për studentët e të drejtës private, atëherë edhe krahasimi fokusohet vetëm në fushën e së drejtës private. Natyrisht se nuk mund të krahasohen të gjitha të drejtat e të gjitha vendeve. Do të trajtohen vetëm të drejtat, të cilat kanë pasur ose edhe kanë ndikim direkt ose edhe indirekt në të drejtën private të Kosovës. Gjithashtu, nuk mund të krahasohen të gjitha institutet, por ato qëndrore dhe më të rëndësishme.
Qëllimet e lëndës:	Për të kuptuar dhe për të zhvilluar të drejtën vetanake (përafrimin e legjislacionit në Evropë), por edhe për zgjidhjen e rasteve me komponentë të së drejtës së jashtme janë të domosdoshme edhe njohuritë në fushën e së drejtës komparative. Ligjërata do të orientohet në njohjen e të drejtës komparative. Në ligjërata do të transmetohen, duke u bazuar në institute qendrore juridike dhe rasteve praktike, njohuritë themelore për familjet kryesore juridike (rrethi juridik gjerman, roman, anglosakson dhe për rendin juridik të vendeve të lindjes). Familjet të tjera juridike (skandinave, aziatike dhe religjioze) nuk do të trajtohen. Nëpërmjet krahasimit të të drejtave të tjera dëshirohet të arrihen njohuri të reja për të kuptuar më mirë dhe më drejtë të drejtën vetanake.
Rezultatet e pritura të	- Studenti do të kuptojë dhe arrijë njohuri për

nxënies:	<p>metodën e krahasimit të të drejtave të tjera;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studenti do të arrijë të njohë familjet kryesore juridike në botë - Studenti do të jetë në gjendje, që të zgjidh raste nga e drejta private, edhe sipas disa të drejtave të caktuara juridike. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	1	2
Ushtrime teorike/laboratorike	/	/	/
Punë praktike	/	/	/
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1	1
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiume,seminare	1	1	1
Detyra të shtëpisë	/	/	/
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	/	/	/
Përgaditja përfundimtare për provim	/	/	/
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	/	/	/
Projektet,prezentimet ,etj	/	/	/
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:	Koncepti didaktik:		
	<p>Fillimisht, në katër ligjëratat e para do të trajtohet teoritikisht e e drejta komparative në fushën e së drejtës private. Pastaj do të trajtohen raste voluminoze, nëpërmjet të cilave do të shtjellohen zgjidhjet sipas të drejtave të vendeve të ndryshme. Rastet janë kryesisht hipotektike dhe që kanë të bëjnë me disa institute tipike në fushën e së drejtës private.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Provimi do të jetë final dhe në afatin e paraparë. Provimi do të jetë me shkrim dhe studentët do të marrin zakonisht një rast për ta zgjidhur sipas të drejtës së vendeve të ndryshme. Esetë nuk përjashtohen. Studentët kanë të drejtë të kenë tekstet ligjore të pakomentuara.</p>		

Literatura	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - Morina, Iset (Editor dhe autor), E drejta komparative në fushën e së drejtës private, Prishtinë 2024 - Bydlinski, Peter, E drejta civile, përkthim në gjuhën shqipe nga Iset Morina dhe Bekim Sermahaj, Prishtinë 2016 (për shkak të së drejtës private austriake) - Fromont, Michel, Sistemet e huaja të mëdha të së drejtës, përkthim në gjuhën shqipe, - Morina, Iset, E drejta e detyrimeve, në: Hyrje në sistemin ligjor në Kosovë, Akademia e Drejtësisë, Prishtinë 2019 - Morina, Iset (Editor), Fjalor juridik - E drejta private, publike dhe penale (shqip-serbisht-anglisht-gjermanisht), Prishtinë 2019 - Zweigert&H.Kotz, Njohuri për të drejtën e krahasuar (parimet themelore), përkthim në gjuhën shqipe nga Marjana Semini, Tiranë 1994. <p>Materialet ligjore:</p> <p>Meqë në ligjërata dhe në provim do të punohet me raste, studentët janë të obliguar që të kenë me vete disa ligje përkatëse dhe atë që nga ligjërata e parë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve; - Ligji për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore; - Kodi Civil i Austrisë (versioni i gjuhës angleze është vetëm në kopje fizike dhe do të jetë në dispozicion në fillim të ligjeratave) - Kodin Civil të Francës (versioni i gjuhës angleze në internet); - Kodin civil Gjerman (versioni i gjuhës angleze në internet); - Kodin Civil të Zvicrës (versioni i gjuhës angleze në internet); - CISG (Konventa e Kombeve të Bashkuara për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave): gjendet edhe në gjuhën shqipe dhe përkthim zyrtar nga RSH

	http://www.cisg.law.pace.edu/cisg/text/Albanian-text.pdf
Literatura shtesë:	Në ligjërata do të ofrohet një listë me të dhëna lidhur me literaturën në gjuhët botërore
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	- Hyrje në të drejtën komparative në fushën e të drejtës private; - Nocioni, Metodat, Raporti me degët tjera të së drejtës, Funkcionet dhe qëllimet
<i>Java e dytë:</i>	- Historia e së drejtës komparative
<i>Java e tretë:</i>	- Familjet juridike në botë
<i>Java e katërt:</i>	- Familja juridike germane
<i>Java e pestë:</i>	- Familja juridike romane
<i>Java e gjashtë:</i>	- Familja juridike anglosaksone/Britani e Madhe/SHBA
<i>Java e shtatë:</i>	- Familja juridike "postsocialiste", Familja juridike skandinave, islame dhe hindu (Bazat themelore)
<i>Java e tetë:</i>	- Rast: Lidhja e kontratës
<i>Java e nëntë:</i>	- Rast: E drejta e shpërblimit të demit nga marrëdhënia kontraktuese
<i>Java e dhjetë:</i>	- Rast: E drejta e personalitetit
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	- Rast: Shpërblimi i demit për shkak të një marrëdhënie të detyrimit nga ligji
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	- Rast: Shpërblimi i demit për shkak të shkakimit të demit
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	- Test ushtrues dhe provues
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	- Rast: Fitimi i pronësisë
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	- Rast: Fitimi i pronësisë